



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, mbledhur në datë 10.10.2022, ora 11:30, në prezencë të anëtarëve të tij, në mbështetje të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat”, duke zhvilluar mbledhjen sipas rendit të ditës,

KONSTATOI:

Dhoma Kombëtare e Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë ka administruar urdhrin nr. 406, datë 24.08.2022, të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e numrit të vendeve për kandidat përmbardues që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbarduesve për vitin 2022”. Sipas këtij urdhri, numri i vendeve për kandidat përmbardues që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbarduesve për vitin 2022 është 15 kandidatë.

Në këto kushte, me daljen e urdhrin të sipërcituar, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 5 të urdhrin nr. 364, datë 31.5.2021 të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e “Programit të detyrueshëm për trajnimin fillestar””, Këshilli Drejtues ka detyrimin të përcaktojë me vendim datën, orën dhe vendin e provimit të pranimit në formimin fillestar.

Në këto kushte, Këshilli Drejtues, me shumicën e votave të anëtarëve të tij,

VENDOSI:

1. Miratimin e thirrjes për shprehje interesi për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar, ku përcaktohen data, ora dhe vendi i provimit të pranimit në formimin fillestar, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kjo thirrje të përcillet për shpallje në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.
3. Kjo thirrje të publikohet të paktën për dy javë rresht në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare dhe t'i kërkohet zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë publikimi i thirrjes dhe në faqen e tyre zyrtare.
4. Ky vendim të bëhet menjëherë publik në respektim të afatit 3 (tre)-mujor përpara datës së caktuar të provimit, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare dhe t'i kërkohet zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë publikimi edhe i këtij vendimi në faqen e tyre zyrtare.
5. Kostot e planifikimit, zhvillimit dhe nxjerrjes së rezultateve të provimit të përballohen nga buxheti i Dhomës Kombëtare.

6. Komunikimet e nevojshme institucionale me qëllim organizimin dhe zhvillimin e provimit, të mbahen nga Kryetari i Dhomës, i cili mban detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES

Z. Alban RULI

Znj. Najada BEQARAJ

Z. Admir BEQIRI

Z. Ilia ELEZI

Z. Fabio ISUFAJ

Z. Bislim SINAJ

Z. Ilir DERVISHAJ